



EmpowerMed

Studim

**Skemat e mbështetjes financiare
për energjitë e rinovueshme dhe
efiçencën e energjisë në Shqipëri**

Projekti Empowermed

**Fuqizimi i grave për të
marrë veprime kundër
varfërisë energjitike në**

Mesdhe



Publikuar nga: Milieukontakt Shqipëri

Datë: Shkurt 2023

Web: www.milieukontakt.org
www.empowermed.eu



Ky projekt financohet nga Programi i Kërkimit dhe Inovacionit Horizon 2020 të Bashkimit Evropian, kontrata Nr. 847052. Autorët janë përgjegjës të vetëm për përmbajtjen e këtij dokumenti. Nuk reflekton domosdoshmërisht mendimin e BE. As EASME dhe as Komisioni Evropian janë përgjegjës për informacionin e përdorur në të.



Përmbajtja:

Hyrja	4
Qëllimi i studimit	4
Koncepti i varfërisë energjitike dhe treguesit e saj	4
Metodologjia e mbledhjes së të dhënave	6
Zhvillimi i sektorit të energjisë në Shqipëri	6
Masa për rritjen e efikasitetit të energjisë në ndërtim	9
Përfitimet e një ndërtese me efikasitet energjie	9
Fizibiliteti dhe investimet për BER dhe EE	10
Proceset rajonale dhe financimi i gjelbër në Shqipëri	11
Kuadri Ligjor	12
Ndryshimet Klimatike në Shqipëri	15
Skemat e mbështetjes financiare në Shqipëri	17
Kompesim për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e cmimit të energjisë elektrike	18
Programi i fondit të komunitetit	20
Programi Kreditor GEF	22
Skema për nxitjen e përdorimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit	25
Bizneset që ofrojnë produkte me efikasitet energjitike me 0% interes	27
Gjetje dhe rekomandime	29
Bibliografia	30

Hyrja

Millieukontakt Shqipëri së bashku me 8 partnerë të tjerë nga Mesdheu po zbaton projektin **EmpowerMed** (Programi i Kërkimit dhe Inovacionit, Horizon 2020) që adreson sfidën e varfërisë energjitike, me fokus të veçantë në përfshirjen dhe fuqizimin e grave. Në vëndet e Mesdheut, zonat bregdetare hasin një sërë sfidash në lidhje me varfërinë energjitike, natyrshëm të lidhura me ngrohjen dhe ftohjen në banesa. Ndërtesat rrallë janë të izoluara, shpesh pa sistem ngrohje, ose jo efikas. Projekti do të trajtojë specifikisht edhe ndikimin e varfërisë energjitike në shëndetin e njeriut. Ky projekt ka filluar në vitin 2019 me mobilizimin dhe rrjetëzimin me aktorët lokal në zonën e Mesdheut (Vlorë – Shqipëri, Barcelonë – Spanjë, Marseille – Francë, Padova – Itali, Primorska – Slloveni, dhe Zadar – Kroaci), vlerësimin e situatës dhe shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave thelbësore për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në zbatimin e masave praktike.

Varfëria energjetike prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe familjet e udhëhequra nga gratë. Në të njëjtën kohë, gratë janë një aktor i rëndësishëm në luftën kundër varfërisë energjetike. Janë ndërmarë disa hapa për të adresuar varfërinë energjitike, si qasje në komunitet, vizita në banesa, mbështetje me investime të vogla si dhe workshope për shëndetin. Aktivitetet e zbatuara janë përkthyer në rekomandime politike të cilat iu janë prezantuar vendimarrësve në nivel lokal dhe qendror. Millieukontakt së bashku me partnerët lokal po advokon për promovimin e politikave që adresojnë varfërinë energjitike. Në këtë kuadër Millieukontakt ka përpiluar një dokument i cili identifikon skemat e mbështetjes financiare për familjet në Shqipëri në lidhje me përdorimin dhe instalimin e energjive të rinovueshme dhe eficientë të energjisë si një mjet për adresimin e varfërisë energjitike dhe fuqizimin e grupeve vunerabël si grate, pensionistët apo dhe grupet e tjera të dizavantazuara. Ky dokument do të shërbejë për orientimin e të gjithë personave apo familjeve të cilat mendojnë të investojnë në shtëpitë e tyre duke u mbështetur tek skemat egzistuese financiare.

Qëllimi i studimit

Identifikimi i skemave të mbështetjes financiare në nivel kombëtar dhe lokal për energjitë e rinovueshme dhe eficientë të energjisë në Shqipëri. Disa nga problemet më të mëdha të ditëve të sotme në vëndin tonë janë të lidhura me sigurinë energjitike, kursimin e energjisë, zhvillimi i burimeve të rinovueshme dhe aplikimi i standarteve mjedisore të cilat kanë lidhje të ngushtë me njera-tjetrën. Kursimi energjetik përbën një nga kushtet themelore për zhvillimin ekonomik të një vëndi dhe gjithashtu mbetet një prej politikave të detyrueshme për vëndet që aspirojnë të jenë pjesë e Bashkimit Evropian. Prandaj është shumë e rëndësishme që të gjithë aktorët e shoqërisë vendimarrës apo jo të ndërmarin iniciativa konkrete për të informuar, mbështetur me skema të ndryshme financimi grupet më të prekura për të përballuar pasojat socio-ekonomike të krizës energjitike që ka prekur të gjithë botën.

Koncepti i varfërisë energjitiqe dhe treguesit e saj

Varfëri energjetike është situata në të cilën një familje nuk mundet të aksesojë shërbimet energjetike në shtëpi në një nivel të tillë që të mund të përballojë nevojat e saj sociale dhe materiale (Bouzarovski dhe Petrova, 2015).

Në vëndet e Evropës, varfëria energjetike i referohet në mënyrë të përgjithshme situatës ku individët nuk janë në gjendje të sigurojnë energjinë e nevojshme në banesë me një çmim të përballueshëm.

Familjet në varfëri energjitiqe përballen me nivel të pamjaftueshëm të energjisë bazë (psh parehati ngrohtësie brenda), shpenzime energjie jo proporcionale që i shtyn në vendimarrje të padëshirueshme (psh dilema 'ngrohtë apo i ushqyer'), ose qasje e pasigurtë në energji (dmth në varësi të furnizimit të paqëndrueshëm, të pasigurtë).

Varfëria e energjitiqe rezultojnë në pabarazitë strukturore në shpërndarjen e të ardhurave dhe aksesin në strehimin cilësor, criminin e pamjaftueshëm të energjisë dhe politikat e ndjeshme të mbështetjes së konsumatorit si dhe nevojat dhe praktikatat e ndryshme të energjisë në shtëpi. Është një formë e veçantë e veçantë e privimit material me një përmasë të qartë gjinore dhe ndikime të shprehura në shëndetin mendor dhe fizik.

Familjet që preken nga varfëria energjetike nuk ka gjasa ta identifikojnë veten se jetojnë në varfëri energjetike, veçanërisht sepse është një term stigmatizues. Në vend të kësaj, varfëria e energjisë duhet të identifikohet duke përdorur tregues.

Disa tregues specifik bazë janë:

- Pamundësia për ta mbajtur shtëpinë mjaftueshëm ngrohtë: Vlerëson mundësinë/aftësinë e vetë raportuar për të mbajtur shtëpinë mjaftueshëm ngrohtë.
- Borxhe për faturat e shërbimeve: Përfshin disa shpenzime për shërbime të tjera nga energjia, por ende është tregues i rëndësishëm sepse kur familjet nuk kanë mundësi të paguajnë rregullisht faturën e energjisë, ato shkëputen nga shërbimi.
- Përqindje e lartë për shpenzime energjie nga të ardhurat: Tregon atë pjesë të popullsisë që ka pjesën e shpenzimit të energjisë ndaj të ardhurave më shumë se dyfishi i pjesës së mesatares në nivel kombëtar.
- Varfëri energjitiqe e fshehur: Tregon atë pjesë të popullsisë që vlera absolute e shpenzimeve të energjisë është më poshtë se gjysma e mesatares absolute në nivel kombëtar, që është shumë e ulët. Kjo vjen si pasojë e efencës së lartë të energjisë, por mund të jetë tregues i familjeve që nuk konsumojnë qëllimisht. Sidoqoftë, shpesh këta tregues nuk maten dhe raportohen, ndaj një numër treguesish të tjerë mund të përdoren për të përshkruar situatat e varfërisë së energjisë. Këto tregues dytësorë janë të rëndësishëm në kontekstin e varfërisë së energjisë, por nuk janë drejt-përdrejt tregues të vetë varfërisë së energjisë.

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Për qëllim të këtij studimi janë përpunuar të dhënat e siguruar nga websitet zyrtare të institucioneve shtetërore, organizmave ndërkombëtare si dhe bizneseve të cilat mbështesin investimet në energji të rinovueshme dhe eficientën e energjisë. Në këtë mënyrë mund të ndihmojmë me informacion për skemat e mbështetjeve financiare konsumatorët familjarë dhe familjet në kushtet e varfërisë energjike.

Zhvillimi i sektorit të energjisë në Shqipëri

Shpërndarja e energjisë elektrike në vendin tonë bëhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), i licencuar nga ERE sipas dispozitave të ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, përbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike, si mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në të gjithë territorin për të cilin është licencuar.

Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike i cili funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore të miratuara në zbatim të tyre. ERE ushtron aktivitetin e saj me qëllim garantimin e përbushjes së detyrimeve të pjestarëve të tregut për të siguruar furnizimin me energji, me cilësi dhe me kosto sa më të ulët për klientët e tij. Kjo, duke patur në konsideratë interesat dhe të drejtat e klientëve, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Kërkesa për energji nga sektori i banesave përbën një sfidë të madhe për vendin tonë pasi ky sektor konsumon 52-55% të konsumit kombëtar të energjisë elektrike. Vlen të theksojmë se në zonat rurale vazhdon konsumi i druve të zjarrit për ngrohje dhe gatim.¹

1) <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2014/06/Bilanci-Komb%C3%ABtar-i-Energjis%C3%AB-2021.pdf>

Ndërgjegjesimi i ulët për përfitimet që sjell investimi në eficientësi e energjisë, mungesa e kapitalit për të investuar janë disa nga pengesat të cilat hasen nga familjet për të të pasur banesa eficiente.

Shqipëria duhet të miratojë ligjin për njohjen e familjeve në kushtet e varfërisë energjike, duke përcaktuar qartë grupet që përfshihen si edhe mekanizmin me të cilin do të mbështeten për të siguruar minimumin e sasisë energjike të nevojshme për konsum në familje.

Duke qenë se energjia elektrike në kohën e sotme përfaqëson një produkt të mënyrës së ekzistencës së shoqërisë njerëzore, si e tillë është shumë e kërkuar dhe shumë e çmuar nga të gjitha kategoritë e jetës dhe veprimtarisë njerëzore prandaj përdorimi racional dhe me eficientësi të lartë i saj është gjithashtu shprehje e veprimit të efektit rregullator.


Kontinenti Evropian po përballë me një krizë të paprecedente energjetike. Shkaku kryesor i krizës është:

- Ngadalësimi ekonomik gjatë pandemisë COVID-19.
- Lufta Rusi - Ukrainë në shkurt 2022 e përkeqësoi më tej situatën.²

Kërkesa për energji nga sektori i banesave përbën një sfidë të madhe për vendin tonë pasi ky sektor konsumon përqindjen më të madhe të konsumit kombëtar të energjisë elektrike. Të dhënat e paraqitura më poshtë për vitin 2021 tregojnë se numri i përgjithshëm i klientëve është 1.279.460 dhe pjesën më të madhe të klientëve të FSHU sh.a. e zënë klientët familjarë që përbëjnë 86.17% të numrit total. Në shpërndarjen demografike të klientëve të FSHU sh.a. pjesa më e madhe është në Tiranë, me rreth 26.5% (viti 2021).

2) Studimi_Konsumi_i_Energjise_Elektrike_ne_Familje_4.09_2009.pdf (ere.gov.al)

Shpërndarja e klientëve sipas kategorive (%)



Grafiku 1 Shpërndarja e numrit të klientëve në vitin 2021 sipas kategorive në % 3

Investimi në efikasitetin e energjisë në banesa përbën një kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm në të tre komponentët e tij:

- në zhvillimin ekonomik
- social
- mjedisor

Investimet për rritjen e efikasitetit energjitik të banesave egzistuese dhe ndërtimi i banesave të reja me teknologji dhe material që kursejnë energji, krijojnë vende pune dhe i japin shtytës ekonomisë. Investimet në fushën e efikasitetit të energjisë përbëjnë një mundësi për të menaxhuar krizat financiare dhe ndryshimet klimaterike. Përshtatja e banesave për shfrytëzimin efikas të energjisë, sikundër dhe ndërtimi i shtëpive të reja duke shfrytëzuar teknologjitë për kursimin e energjisë, përbën përfitim të dyfishtë në shëndetin dhe të ardhurat e familjeve.

3) <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2014/06/Bilanci-Komb%C3%ABtar-i-Energjis%C3%AB-2021.pdf>

Masa për rritjen e efijencës së energjisë në ndërtime

Ndër masat kryesore që mund të ndërmerren për rritjen e efijencës së energjisë në sektorin e ndërtimeve janë:

- Reduktimi i humbjeve të nxehtësisë nga ndërtesa duke përmirësuar mbrojtjen termike të jashtme të saj.
- Rritje e përfitimeve të nxehtësisë nëpërmjet orientimit dhe përdorimit të energjisë diellore.
- Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në ndërtesa (biomasë, energji diellore, energjia e erës, energjia gjeotermike etj).
- Përmirësimi i efijencës së energjisë në sistemin ngrohës të përdorur në ndërtesë.
- Emetimet e CO2 të shkaktuara nga përdorimi në rritje i lëndëve djegëse fosile në sektorin e banesave kanë ardhur gjithmonë në rritje. Ndërmarrja e këtyre masave për rritjen e efijencës së energjisë në sektorin e banesave bëhet me qëllim reduktimin e konsumit të të gjitha formave të energjisë në ndërtesa. Kjo gjë rezulton në uljen e emetimeve të CO2 dhe gazeve të tjerë të dëmshëm në mjedis.

Përfitimet e një ndërtesë me efijencë energjie

Të ndërtosh një ndërtesë efijente presupozon projektimin, procesin e ndërtimit të ndërtesës së re të termoizoluar dhe izolimin e asaj ekzistuese. "Efijenca e energjisë" nënkupton raportin në përqindje, të energjisë në dalje me energjinë në hyrje, në të njëjtin sistem energjetik, që në rastin tonë është ndërtesa. Ky është përcaktim teorik i saj. Më thjesht do të thonim se "Efijencë Energjie" kemi atëherë kur në një proces energjetik arrijmë rezultate të njëjta duke përdorur më pak energji. Teprica e energjisë në këtë rast është energjia e kursyer nga marrja e masave për të ulur sasinë e përdorur në këtë proces.

Përfitimet nga një ndërtim efijent janë:

- Kursejme energji dhe si rrjedhim më pak para për faturën e energjisë.
- Më shumë rehati dhe më shumë cilësi të jetës.
- Jetë më të gjatë të ndërtesës.
- Kontribut në mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e emetimeve ndotëse në mjedis.
- Rritje të vlerës së banesës.

Masat që duhen marrë për rritjen e efijcensës së energjisë në ndërtesa janë:

- Termoizolim i ndërtesës
- Dyer dhe dritare dopio xham
- Elemente mbrojtës nga dielli
- Ngrohje qëndrore
- Ndrichim efijcent
- Paisje elektroshtëpiake efijcente
- Përdorim i burimeve të rinovueshme të energjisë në ndërtesë
- Kontroll dhe mirëmenaxhim i energjisë në ndërtesë

Humbjet në ndërtesë vijnë kryesisht nga:

- Muret
- Dyshemeja
- Çatia
- Dyer dhe dritare
- Nyjet termike

Fizibiliteti dhe investimet për burimet e energjisë së rinovueshme dhe efijcencën e energjisë

Tranzicioni i energjisë së rinovueshme do të sjellë shumë ndryshime në aspekte të ndryshme të sektorit të energjisë. Nëse nuk miratohen masat e duhura, ndryshimet në sektorin e energjisë mund të rrisin numrin e familjeve të rrezikuara nga varfëria energjitike. Rritja e tarifave për shkak të skemave të mbështetjes së Burimeve të Energjisë së Rinovueshme mund të bëhet një barrë shtesë për popullatën e ndjeshme ndaj energjisë. Mbyllja e hendekut financiar ose pagesa e faturave të rritura të energjisë mund të jetë e parealizueshme për familjet në nevojë. Në fakt, individët me të ardhura të ulëta shpesh qëndrojnë jashtë fushës së masave të efijcencës së energjisë. Aty ku ka shumë familje të rrezikuara nga energjia, zgjidhjet e efijcencës së energjisë duhet të synojnë specifikiisht edhe klientët e prekshëm. Ndryshimi i shpejtë në sistemin e energjisë kërkon një mënyrë të re për të kuptuar politikat e energjisë së rinovueshme. Për këtë arsye, politikat për të mbështetur tranzicionin duhet të miratojnë një qasje holistike që llogarit këto elemente.

Politikat që nxisin tranzicionin duhet të mbulojnë jo vetëm vendosjen e burimeve të rinovueshme, por edhe integrimin e tyre në sistemin më të gjerë të energjisë dhe politikave ekonomisë, të cilat ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe ritmin e tranzicionit (IRENA / IEA / REN21, 2018). Si pasojë, hartimi i politikave mbështetëse për vendosjen e energjisë së rinovueshme në një situatë të cenueshmërisë difuze të energjisë ose varfërisë duhet të adresojë përballeshmërinë e energjisë, e cila nga ana e saj varet nga modelet e konsumit dhe çmimi i energjisë, dhe duhet të jenë zgjidhje afatgjata për çështjet e varfërisë së energjisë dhe masat e eficiencës së energjisë.

Masat e eficiencës së energjisë janë të nevojshme në shumicën e familjeve të varfëra nga energjia dhe të rrezikuara nga ajo. Efikasiteti i energjisë zvogëlon konsumin e energjisë dhe përmirëson cilësinë e jetës në banesa (zvogëlimi i lagështisë dhe ndotjes së brendshme të ajrit). Zgjidhjet e eficiencës së energjisë nuk u referohen vetëm banesave, por edhe pajisjeve energjetike. Masat e eficiencës së energjisë zvogëlojnë gjithashtu nevojën për subvencione tarifore, duke hapur hapësirën fiskale për investime më të mëdha në energji të rinovueshme dhe teknologji të tjera të pastra. Teknologjitë moderne të biomasës mund të ndihmojnë në zvogëlimin e ekspozimit ndaj energjisë dhe ndryshueshmërisë së çmimit të karburantit, ndërsa përmirësojnë cilësinë e ajrit të brendshëm dhe zvogëlojnë sasinë e biomasës së nevojshme për të ngrohur një banesë. Në mënyrë të ngjashme, ngrohësit diellorë të ujit ulin fakturat e energjisë për përfitim e ujit të nxehtë, duke përmirësuar jetesën e familjeve.

Subvencionet financiare mund të jenë të nevojshme për t'i bërë teknologjitë moderne të ngrohjes së rinovueshme të përballeshme. Identifikimi i pikave të nxehta të varfërisë dhe vulnerabilitetit të energjisë lejon përpjekje që mund të rezultojnë në politika më efektive, të përshtatura, të përqendruara në çështjet më të rëndësishme, të cilat mund të ndryshojnë nga rajoni në rajon.

Proçeset rajonale dhe financimi i gjelbër në Shqipëri

Nëpërmjet Marrëveshjes së Gjelbër, BE-ja mbështet edhe vendeve fqinje, duke pranuar se tranzicioni mund të jetë plotësisht efektiv nëse zhvillohet edhe përmes administrativë të Bashkimit. Me këtë qëllim, është hartuar Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (European Commission, 2020) si një nga veprimet kryesore në kuadër të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Objektivi kryesor është caktimi i neutralitetit në ndikimin për klimën për vitin 2050 edhe në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, të cilat janë në procesin e para-anëtarësimit. Njëkohësisht me objektivat e saj Bashkimi Evropian e ka filluar mbështetjen financiare të vendeve të Ballkanit Perëndimor në drejtimin e zhvillimit / ekonomisë së gjelbër.

Levizje drejt zhvillimit të gjelbër ka pasur edhe në vendin tonë. Bankat kanë nisur të integrojnë faktorët mjedisorë në operacionet e tyre, veçanërisht në fusha si energjia e rinovueshme, përmirësimi i efikasitetit energjetike dhe sektori bujqësor. Por më shumë duhet bërë për t'i rritur këto mekanizma. Të tjera segmente të sektorit financiar, si bursa dhe fondet e investimit mund të luajnë një rol në gjelbërimin e ekonomisë. Financimi i gjelbër është një trend në rritje në Europë, për faktin se investitorët fitojnë para me ndërgjegjen e pastër se po bëjnë njëkohësisht mirë për ambientin. Ky mekanizëm i ri financiar është shumë tërheqës dhe shpesh ofron interesa më të ulëta se financimi tradicional.

Institucionet financiare në Shqipëri po shtojnë theksin në financimin e projekteve që ulin efektin negativ në mjedis, që rrisin efikasitetin në konsumin e energjisë dhe ulin gjurmët e karbonit. Ekonomia e gjelbër është e vetmja mënyrë për të pasur të ardhme të shëndetshme për brezat e rinj dhe në vendin tonë. Si të gjitha industritë, edhe ajo bankare, ka rolin e saj mjaft të drejtpërdrejtë në vendosjen e gjurmës së gjelbër në Shqipëri.

Kuadri Ligjor

Politikat Kombëtare

Strategjia Kombëtare për Energjinë ka përcaktuar synimet energjetike të vendit për të mundësuar integrimin evropian të Shqipërisë në të gjithë infrastrukturën energjetike evropiane. Objektivat e strategjisë janë:

- Synimi i energjive të rinovueshme kundrejt konsumit total do të arrijë 42% në vitin 2030.
- Reduktimi i emetimeve të GS-ve kundrejt totalit do të arrijë 11.5% në vitin 2030.

Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë që përcakton synimet e EE-së për të gjithë sektorët ekonomik dhe socialë. Mbështetja ndërkombëtare mund të vazhdojë, por për të rritur veprimet e EE-së kërkohet disponueshmëria e fondeve të rritura kombëtare (publike dhe private). Për të realizuar pjesën më të madhe të masave të EE-së, ligji i EE-së kërkon zhvillimin e një Fondi për Eficiencën e Energjisë, si mekanizëm i mbështetjes financiare për zbatimin e projekteve të EE-së në sektorin publik dhe privat. Duhet parë si mjet për shfrytëzimin e burimeve të mëdha nga palët e jashtme (donatorët si dhe bankat private).

Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme që përcakton synimet e BRE-ve për të gjithë sektorët e energjisë elektrike, transportit dhe ngrohjes. Ky Plan bazohet në detyrimet e Shqipërisë si Palë Kontraktuese në Traktatin e Komunitetit të Energjisë për të qenë në përputhje me Direktivat e BE-së për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Shqipëria është e detyruar të rrisë pjesën e burimeve të rinovueshme në 38% të konsumit total të energjisë deri në vitin 2020, e cila duhet të rritet më tej deri në 42.5% deri në vitin 2030.

Ligjet

Ligji për Burimet e Rinovueshme të Energjisë nr. 7/2017 transponzon pjesërisht Direktivën 2009/28 / të BE-së. Objektivi i Ligjit për BRE-të është lehtësimi i shfrytëzimit të burimeve të konsiderueshme të ER-së të Shqipërisë, në HEC-et e vogla, Sistemet me Ujë të Nxehtë Diellor, Centrale Elektrike PV, sistemet efikase të ngrohjes tradicionale dhe industriale të biomasës, si dhe burime të tjera të ER-së.

Ligji për Performancën e Energjisë së Ndërtesave Nr. 116/2016. Ky Ligj përfshin kërkesat për ndërtesat e reja në shfrytëzim dhe në pronësi të autoriteteve publike për të përmbushur përcaktimin e Ndërtesave me Energji Pothuajse Zero (NEPZ).

Ligji për Eficiençën e Energjisë Nr. 124/2015 për të transpozuar dispozitat e Direktivës së BE-së 2012/27 / BE në komizën legjislative shqiptare.

Ligji për Etiketimin e produkteve që lidhen me energjinë Nr. 68/2012, i cili transponzon plotësisht Direktivën e BE-së 2010/30 / BE. Ky ligj përcakton detyrimin për informimin e konsumatorëve për konsumin e energjisë së produkteve të lidhura me energjinë.

Ligji Nr. 9876/2008 për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e bio-lëndëve djegëse dhe lëndëve të tjera të rinovueshme të përdorura në transport promovon prodhimin dhe përdorimin e bio-lëndëve djegëse të rinovueshme për të zëvendësuar nënproduktet e naftës në sektorin e transportit.

Ligji Nr. 9501/2006 për ratifikimin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, i cili siguron një kornizë ligjore për konvergjençën me acquis-in e energjisë të Bashkimit Evropian .

Ligji Nr. 8987/2002 për krijimin e ambienteve për ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë

VKM Nr.1094 / 2020 për miratimin e metodologjisë kombëtare për llogaritjen e performancës së energjisë të ndërtesave.

VKM Nr.934 / 2020 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për mënyrën e përzgjedhjes së certifikatave të performancës së energjisë të ndërtesave që do të jenë objekt vlerësimi si dhe procesi i monitorimit të tyre.

VKM Nr.537 / 2020 për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave.

VKM Nr.580/2019 për miratimin e Planit të Konsoliduar Kombëtar të veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë.

VKM Nr.407/2019 për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve dhe eksperiencës profesionale për energjinë.

VKM Nr.342 / 2019 për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve për audituesit e energjisë.

VKM Nr. 27 / 2018 për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorë e vegjël me BRE duke përdorur pjesën e bio-degradueshme të mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

VKM Nr. 349/2018 për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve të tyre, të ndryshuar.

VKM Nr. 430/2018 për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-leje)

VKM Nr.687 / 2017 për miratimin e metodologjisë për caktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet Prodhuesve Ekzistues me Përparësi.

VKM Nr. 369 / 2017 për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.

VKM Nr. 852/2016 për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë.

VKM Nr. 519/2016 për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike.

VKM Nr. 822/2015 për miratimin e rregullave dhe procedurave për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt i koncesioneve, të ndryshuar.

VKM Nr. 839/2007 për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për rimbursimin e akcizës së paguar dhe krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MË, të ndryshuar.

Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 229 / 2019 për miratimin e Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të Originës për energjinë elektrike të prodhuar nga BRE-ja.

Udhëzimi i MIE-së Nr. 3/2019 për Miratimin e Procedurës së Autorizuar për Lidhjen me Sistemin e Shpërndarjes të Projekteve të Vogla të Rinovueshme për Vetë-Prodhuesit e Energjisë Elektrike nga Dielli.

Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-së Nr. 214 / 2017 për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjen për Pjesëmarrjen në Bursën Shqiptare të Energjisë.

Ndryshimet Klimatike në Shqipëri

Ndryshimet klimatike po kërcënojnë zhvillimin e qëndrueshëm në të gjithë botën gjithashtu edhe në rajonin e Ballkanit. Kushtet ekstreme klimatike të motit po ndodhin më shpesh vitet e fundit me një intensitet më të lartë krahasuar me vite më parë duke ndikuar në jetët e miliona njerëzve. Impakti i ndryshimeve klimatike ndjehet tek shëndeti i njeriut, në ekosistem, në burimet natyrore, në bujqësi, në burimet ujore dhe vit pas viti bëhen edhe më të dukshme. Energjia, bujqësia, pyjet, turizmi dhe siguria njëzore janë ndër sektorët ekonomik që preken më shumë nga efektet e ndryshimeve klimatike. Shqipëria është një nga vendet më të prekura në rajon prej këtyre ndryshimeve. Tendencat e ndryshimeve klimatike janë vënë re kryesisht gjatë 15 viteve të fundit me: rritjen e temperaturave, uljen e reshjeve dhe një shfaqje më të shpeshtë të fenomeneve ekstreme të motit, si periudhat me thatësi dhe përmbytjet.

Për të reaguar ndaj ndryshimeve ekstreme të motit qeveria Shqiptare ka miratuar në vitin 2020 "Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike" në përputhje me legjisllacionin dhe objektivat e BE-së për klimën dhe mjedisin, i cili synon forcimin e bashkërendimit mes sektorëve, lidhur me masat zbutëse për klimën, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Dokumenti strategjik mbulon katër sektorë raportues të inventarit të gazeve serë: Energjia me fokus të veçantë Transportin; Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjeve, Mbetjet; Ndërtesat dhe Industria, të cilat janë përgjegjëse për 80% të shkarkimeve të CO₂ në Shqipëri.

Vendi ka profil unik të emetimit pasi prodhimi i energjisë elektrike bazohet aktualisht në prodhimin e burimeve të rinovueshme, me energjinë hidrike që siguron pjesën më të madhe të saj. Fatkeqësisht, kapacitetet hidro-energetik është i prekshëm nga ndikimet e ndryshimeve klimatike. Përzjerja unike e energjisë elektrike në Shqipëri është pozitive për faktin se sistemi elektrik është në nivel të dekarbonizimit, gjë të cilën vendet e tjera synojnë ta arrijnë vetëm në plane afatgjatë, por gjithashtu do të thotë se ka mundësi të kufizuara për politika dhe masa të mëtejshme në këtë sektor për të reduktuar emetimet. Ruajtja e përmbytjes së ulët të emetimit të gazeve serë në prodhimin e energjisë elektrike dhe shkëputja e rritjes ekonomike nga rritja e emetimeve të gazeve serë në sektorë të tjerë janë faktorët kryesorë të vendit në lidhje me kontributin e zbutjes siç është Kontributi Kombëtar i Përcaktuar.

Ne tabelën më poshtë jepen shpenzimeve e qeverisë shqiptare për klimën, të shtrira sipas tre sektorëve, për 2019-2020, ku vëme re një dominim të tyre nga sektori i energjisë, i cili përfaqëson gjysmën e shpenzimit të resor, (pra që përfshin realizimet gjatë 2019, 2020). Kjo tregon qartë për mungesën e financimeve dhe sidomos të mekanizmave financiarë për të mbështetur grupet vunerabël.

Në tabelën më poshtë jepen shpenzimet e qeverisë shqiptare për klimën, të shtrira sipas tre sektorëve, për 2019-2020, ku vëme re një dominim të tyre nga sektori i energjisë, i cili përfaqëson gjysmën e shpenzimit tërësor, (pra që përfshin realizimet gjatë 2019-2020). Kjo tregon qartë për mungesën e financimeve dhe sidomos të mekanizmave financiarë për të mbështetur grupet vunerabël.

Sektori / Vitet	Energjia (eur)	Mjedisi (EUR)	Bujqësia (EUR)
2019	5,302	2,004	7,211
2020	11,280,963	1,908,150	8,363

Sektori i energjisë përfaqëson gjithashtu ekstremet më të mprehta mes vlerave (minimum dhe maksimumin) të shpenzimeve. Megjithatë kemi një luhatje me mbi 80% të këtij treguesi në krahasimin mes viteve 2019 dhe 2020, në sektorin e energjisë, duhet thënë se vlera e tij në vitin 2019 është tejet e ulët për shkak të recensionit që krijoi tërmeti dhe pandemia. Në dy sektorët e tjerë, mjedis dhe bujqësi këto ndryshime paraqiten më të qendrueshme, por gjithsesi paraqesin shpenzime në nivele mjaft të ulëta, krahasuar me nevojat.

Skemat e mbështetjes financiare në Shqipëri



Kompesim për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e cmimit të energjisë elektrike

Qëllimi i këtij procesi kompensimi është stimulimi dhe mbeshtetja e shtresave në nevojë për të paguar fatuarat e energjisë elektrike.

Ky kompensim ofrohet për të gjithë pensionistët që janë kryefamiljarë, që janë të vetëm, ose janë vetëm dy pensionistë në familje, si dhe për pensionistët kryefamiljarë që kanë persona në ngarkim që i kanë në moshë madhore pune, por janë të papunë. Po ashtu, kompensim përfitojnë edhe kryefamiljarët, që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat, si dhe familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto minimale, kur punonjësi është kryefamiljar.

Kushti për të përfituar kompensim për këto kategori është që personi të mos ketë asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar. Ndërkaq, dy kategoritë e fundit që kompensohen për energjinë elektrike janë të verbrit si dhe personat paraplegjikë e tetraplegjikë. Procedura për ta përfituar këtë lloj kompensimi është të paraqiten në agjencite lokale të sigurimeve shoqërore, ku personi ka qendrën e banimit. Atje pajisen me deklaratën, plotësojnë dhe dokumentacionin dhe marrin një konfirmim që kanë depozituar kërkesën.

Procesi i pagimit të kompensimit të cmimit të energjisë elektrike në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë datë 14.01.2015 ka nisur që në datën 1 shkurt 2015.

Të gjithë pensionistët që përfitojnë këtë lloj kompensimi, së bashku me pensionin e muajit shkurt kanë tërhequr kompensimet e energjisë elektrike në masën 1288 lekë. Kjo shumë përfshin të tre llojet e kompensimeve të çmimeve të energjisë që janë kompensimi i parë sipas VKM nr 565, datë 09.08.2006 prej 500 lekësh, kompensimin e dytë sipas VKM 238, datë 7.04.2010 prej 140 lekësh si dhe kompensimin e fundit prej 648 lekësh sipas VKM nr. 8, datë 14.01.2015.

Kriteret bazë për të aplikuar

Kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike në masën 648 lekë, e përfitojnë të gjitha kategoritë e pensioneve, si më poshtë:

1. Kryefamiljar në pension pleqërie shtetëror ose fshati por me banim në qytet
2. Kryefamiljar në pension invaliditeti
3. Nuk ka anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar, jeton vetëm ose qe ka fëmijë në ngarkim pa të ardhur.
4. Ka kontratë me OSSH-në (shënuar në faturën e shitjes apo librezën e dritave në emër të tij)
5. Nuk ka dysheme për konsumin e energjisë elektrike
6. Nuk ka detyrime të papaguara të energjisë elektrike.

Cilat janë dokumentat e nevojshëm?

1. Deklaratë personale që plotësohet nga përfituesi pranë Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore në vendbanimin e tij
2. Fotokopje e kontratës të energjisë elektrike nga operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike
3. Çertifikatë familjare (kur ka fëmijë në ngarkim në moshën 18 vjeç dhe/ose kur vazhdojnë shkollën deri në 25 vjeç duhet paraqitur edhe vërtetimi i shkollës ndërsa kur ka persona në ngarkim mbi këtë moshë, duhet të paraqitet dhe vërtetimi nga zyrat e punësimit, nga zyra tatimore e Bashkisë dhe Qendrës Administrative dhe nga zyra e tatim-taksave).
4. Fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit (pensionist/invalid)
5. Fotokopje të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose fotokopjen e vendimit të KMCAP-it/ KMVP (të verbrit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët)

Adresa e websitit ose tel per me shume info

Email: kontakt@issh.gov.al

TEL: 042230484

Programi i fondit të komunitetit

Qëllimi: Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe Bashkisë së Tiranës duke krijuar një skemë efektive bashkëfinancimi me qëllim përmirësimin e ambienteve në bashkëpronësi.

Programi "Fondi i Komuniteteve" synon të nxisë bashkëpunimin efektiv në mesin e qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të banimit dhe ruajtjen e ambienteve në pronësi të përbashkët. Nëpërmjet një skeme fondesh të vëna në dispozicion nga Bashkia e Tiranës, banorët e lagjeve të ndryshme (bashkëpronarët e ambienteve të banimit) të kryeqytetit mund të organizohen së bashku nën udhëheqjen e Autoriteteve për të përfituar bashkëfinancim për projekte infrastrukturore të cilat adresojnë një problem të caktuar në komunitetin e tyre. Nëpërmjet këtij programi synohen të arrihen një sërë objektivash, të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me përmirësimin e ambienteve të përbashkëta, por gjithashtu synojnë ndryshimin e mentalitetit të bashkëpunimit mes qytetarëve dhe institucioneve publike. Ky program përbën një mundësi mjaft të mirë për ta kthyer qytetarin në pjesë thelbësorë të procesit vendimmarrës kundrejt nevojave personale dhe atyre të komunitetit. Gjithashtu programi kontribuon në ndërgjegjësimin e tij duke i dhënë më shumë përgjegjësi në menaxhimin e fondeve dhe në mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta.

Ky fond parashikon financimin e projekteve të cilat zbatohen brenda territorit administrativ të Bashkisë Tiranë. Shuma totale e fondit parashikohet sipas buxhetit të vitit përkatës të miratuar në Këshill Bashkiak. Kjo shumë parashikohet të shpërndahet në disa projekte bashkëfinancimi, të cilat do të përzgjidhen përmes thirrjeve për aplikim. Fondi limit i aplikimit do të vlerësohet në bazë të projekteve aplikuese, duke marrë në konsideratë tipologjinë e projektit, impaktin e tij në komunitet dhe sipërfaqen që parashikon të mbulojë deri në vlerën prej 10% të fondit të miratuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë për Programin e Fondit të Komuniteteve". Fondi limit i aplikimit nuk duhet të tejkalojë vlerën prej 5.000.000 lekë. Një nga kriteret e dhënies së fondit është kriteri i bashkëfinancimit. Bashkëfinancimi nga bashkëpronarët duhet të jetë i masës minimalisht 50% e fondit total (fondi total i projektit = fondi i Bashkisë Tiranë + fondi i mbledhur nga bashkëpronarët).

Si të aplikojmë për "Fondin e Komuniteteve"

Për të aplikuar për Fondin e Komunitetit administratori duhet të jetë i listuar tek "Libri i Administratorëve" mbajtur nga Bashkia Tiranë, gjithashtu duhet të ketë lidhur kontratë me kryesinë e pallatit.

Si të aplikojmë për "Fondin e Komuniteteve"

Për të aplikuar për Fondin e Komunitetit administratori duhet të jetë i listuar tek "Libri i Administratorëve" mbajtur nga Bashkia Tiranë, gjithashtu duhet të ketë lidhur kontratë me kryesinë e pallatit.

Kriteret Bazë për të aplikuar në Programin Fondi i Komuniteteve

Objekti duhet të jetë i regjistruar tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës. (Hipotekuar)

Objekti duhet të ketë Kryesi të regjistruar tek "Regjistri i Bashkëpronësisë" mbajtur nga Bashkia Tiranë.

Kryesia duhet të ketë lidhur kontratë administrimi me administrator të regjistruar në "Librin e Administratorve" mbajtur nga Bashkia Tiranë.

Cilat janë dokumentat e nevojshëm?

1. Formular Aplikimi (plotësuar në mënyrë elektronike).
2. Dakordësia midis bashkëpronarëve, ku minimalisht të garantohet 50%.
3. Fotokopje të dokumentave të pronësisë së bashkëpronarëve ku do të kryhet investimi.
4. Dokumentacioni ku vërtetohet se bashkëpronarët kanë paguar taksën për pasurinë e paluajtshme.
5. Projekt Teknik (format A3 origjinale dhe CD format DĒG), hartuar nga projektues i licensuar.
6. Plan Pune (3 kopje origjinale), hartuar nga projektues i licensuar.
7. Preventiv (3 kopje origjinale), hartuar nga projektues i licensuar.
8. Relacion (3 kopje origjinale), hartuar nga projektues i licensuar.
9. Specifikime Teknike (3 kopje origjinale), hartuar nga projektues i licensuar.
10. Dokumentacion plotësues për familjet në nevojë që përfitojnë 100% të tarifës së investimit:

Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike:

- Certifikatën e pronësisë.
- Vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për familjet që përbëhen vetëm nga pensionistë:

- Certifikatën e pronësisë dhe certifikatë familjare.
- Vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Të gjitha dokumentat dorëzohen tek Njësia Administrative përkatëse.

Adresa e websiteit ose tel per me shume info

<https://tirana.al/artikull/si-te-aplikojme-per-fondin-e-komuniteteve>

TEL: 0800 0888

Email: info@tirana.al

Programi Kreditor GEFF

Programi Kreditor për Financimin e Ekonomisë së Gjelbër (GEFF) i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Ballkanin Perëndimor.

Qëllimi kryesor i këtij financimi të gjelbër është të ndihmojë familjet që të rrisin nivelin e efikasitetit energjetic, duke reduktuar emetimet e dioksidit të karbonit dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës.

Programi Kreditor për Financimin e Ekonomisë së Gjelbër (GEFF) siguron financim për sektorin e banimit si dhe për bizneset që ofrojnë produkte të efikasitetit të energjisë, produkte të energjisë së ripërtëritshme si dhe shërbime për individët. Vëllimi i përgjithshëm i linjës kreditore në Ballkanin Perëndimor domethënë në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Serbi dhe në Maqedoninë e Veriut është 85 milionë euro. Financimi i GEFF realizohet nëpërmjet institucioneve financiare partnere të programit, të cilët e përdorin kredinë për financimin e huamarrësve të përshtatshëm që duan të investojnë në projekte që përfshihen në këtë program. GEFF në financim me disa banka tregtare në Shqipëri i mundëson klientit rimbursim të 20 % të shumës së investuar me qëllim rritjen e efikasitetit të energjisë.

Nga skema mund të përfitohet për investimet që huamarrësi kryen në mënyrë direkte, por edhe në blerjen e një pasurie të paluajtshme, që plotëson kriteret e kërkuara të efikasitetit energjetic. Edhe në rast se investimi është bërë nga ndërtuesi, qytetari që e blen pronën me kredi i rimburohet përqindja përkatëse e investimit të kryer për këtë qëllim. Nga ana tjetër, me përdorimin e produkteve që ofrojnë efikasitetin energjetic për përdoruesin, vetë përdoruesi kursen në afatgjatë në pagesa të energjisë elektrike krahasimisht me përdorimin e një pajisjeje që nuk është çertifikuar në këtë aspekt.

Banka favorizon përmes GEFF pikërisht blerjen dhe përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve të çertifikuara si eficientë për energjinë dhe miqësore për mjedisin. Për Shqipërinë, institucionet financiare partnere janë Procredit Bank, Banka Kombëtare Tregtare dhe Union Bank.

Për individët, skema mund të rimburojë 15% të kostove të pranueshme për një projekt brenda një banese individuale që përfshin një kategori të vetme të teknologjisë, ose 20% të kostove të pranueshme për një projekt brenda një banese individuale ku përfshihen paketa me më shumë se një kategori të teknologjive të zgjedhura. Për grupet e individëve, apo ndërtesat shumëkatëshe të banimit, skema parashikon mbulimin e 25% të kostove të pranueshme për një projekt të ndërtesave të banimit shumëkatëshe, që përfshin një kategori të vetme të teknologjive, ose 35% të kostove të pranueshme për një projekt të ndërtesave të banimit shumëkatëshe, me paketa me më shumë se një kategori të teknologjive.

Kategoritë për GEFF dhe kriteret bazë për të aplikuar

Kategoritë e mëposhtme të huamarrësve janë të përshtatshëm për hua në kuadër të këtij programi:

- Individë të cilët kanë në pronësi ose jetojnë në një shtëpi apo banesë në të cilën planifikojnë që të zbatojnë investimin e përshtatshëm
- Grupe të individëve, shoqatat për banim, shoqatat e pronarëve të ndërtesave shumëkatëshe ose organe të tjera ekuivalente të cilat përfaqësojnë interesat e banorëve.
- Ofruesit e shërbimeve, si kompanitë e menaxhimit të strehimit dhe kompanitë për shërbime energjetike (ESCO) që ofrojnë mirëmbajtje, instalim, konstruktion, rinovim ose shërbime të ngjashme sipas marrëveshjeve kontraktuale me individë.
- Tregtarët që ofrojnë dhe/ose shesin materiale me efikasitet energjie. Financimi është i mundshëm për individë që zotërojnë ose banojnë në një shtëpi ose apartament në të cilin ata synojnë të zbatojnë investimin e pranueshëm. Financimi i teknologjive përfshin gjithashtu kostot e materialeve ndihmëse, transportit dhe instalimit deri në përqindjen maksimale të përcaktuar të kostove të teknologjisë.

Rinovimi i ndërtesave me shumë apartamente nga grupe individësh, ofruesit e shërbimeve, si dhe zgjerimi i shitjeve ose prodhimi i teknologjive të pranueshme nga tregtarët dhe prodhuesit janë lloje të investimeve që kërkojnë një vlerësim shtesë pasi ato janë shumë të ndërlikuara për të aplikuar përfaqesën e thjeshtë të teknologjive të miratuara paraprakisht.

Programi ka zhvilluar një bazë të dhënash për pajisjet dhe materialet shtëpiake me performancë të lartë që përmbushin standardet e performancës të përcaktuara nga BERZH (EBRD) për GEFF në Shqipëri.

Si të aplikojmë për GEFF?

Për të aplikuar për financimin në kuadër të programit GEFF mund të ndiqen dy rrugë:

● Drejtpërdrejtë në Institucionet Financiare Partnere të Programit

● Kontaktoni GEFF

Plotësoni formularin e aplikimit të institucionit financiar partner që keni përzgjedhur dhe e dorëzoni atë së bashku me dokumentet e lartpërmendura. Institucionet Financiare Partnere do ta vlerësojnë përshtatshmërinë tuaj për financim sipas kushteve të GEFF, aftësinë tuaj kreditore në përputhje me standardet dhe procedurat e brendshme të institucionit si dhe bazuar në faktin që teknologjia e shënuar në çertifikatën e përshtatshmërisë është e regjistruar në selektorin e teknologjisë. Pas vlerësimit pozitiv, do t'ju sigurohet financimi për ta blerë teknologjinë e zgjedhur. Merrni masa për instalimin e teknologjisë. Kujdesuni që të keni faturën dhe dëshminë e pagesës si dhe certifikatat e instalimit/certifikatat e komisioneve (nëse aplikohen) që të mund t'i prezantoni kur të kërkonti verifikimin.

Në mënyrë që të kualifikoheni për grant, ju lutemi kini parasysh se pajisjet e instaluar në shtëpinë tuaj duhet:

Të jenë të vlerësuara si të pranueshme nga ekipi GEFF.

Të përputhen plotësisht me teknologjitë e përshkruara në faturën e dorëzuar së bashku me kërkesën për verifikim.

Ekipi i GEFF do të verifikojë nëse teknologjia është instaluar, gjë që mund të kërkojë gjithashtu një konfirmim dhe vizitë në terren (në shtëpinë tuaj).

Pas verifikimit të suksesshëm, institucioni financiar partner do të paguajë grantin në llogarinë tuaj.

Adresa e websitit ose tel për me shume info

albania@ebrdgeff.com

TEL: +355 / 69 79 065 91

Skema për nxitjen e përdorimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit.

Skema për financim dhe nxitjen e përdorimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit. Kjo skemë financimi synon subvencionimin në masën 70% të kostos nga Agjencia për Eficiençën e Energjisë. Nëpërmjet kësaj mase synohet:

- Reduktimi i konsumit të energjisë elektrike dhe përmirësimi i furnizmit me ujë të ngrohtë
- Reduktimi i emetimeve të dioksidit të karbonit CO2.

Klientët familjarë mund të aplikojnë me dokumentacionin në përputhje me kriteret e publikuara në faqen zyrtare të AEE, eee.eficenca.gov.al duke filluar nga data 1 Nëntor 2022. Kriteret Bazë për të aplikuar në skemën e subvencionimit të paneleve diellore. Klientet familjarë që kërkojnë të aplikojnë për përfitimin e mbështetjes për realizimin e investimit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të paraqesin një kontratë ekzistuese me OSHEE ku të jenë të klasifikuar si abonent familjar dhe një historik të konsumit të energjisë për të paktën 6 muaj, që nuk duhet të jetë më pak se 250 kwh për cdo muaj. Ky kriter nuk është i zbatueshëm për klientët që trajtohen me ndihmë ekonomike nga ministria përgjegjëse për punët sociale.
2. Të vërtetojnë se nuk janë debitorë kundrejt OSHEE/FSHU.
3. Të zotërojnë çertifikatë pronësie për banesën (rastet që janë në proces legalizimi nuk do të konsiderohen).

Cilat janë dokumentat e nevojshëm?

Lista e dokumentave që duhet të paraqesin konsumatorët familjarë për aplikim në plat-formën online:

1. Letërnjoftimi (pasaportë/kartë identiteti)
2. Certifikata Familjare
3. Certifikatë Pronësie
4. Faturat e energjisë elektrike për 6 muajt e fundit
5. Vërtetim debie nga e-albania që nuk janë debitorë kundrejt OSHEE

6. Foto në të cilat tregohet qartë pamja e jashtme e objektit ku do të instalohen panelet diellore për ngrohjen e ujit.
7. Sipas rastit dokument që vërteton se janë përfitues të ndihmës ekonomike;
8. Formulari e vetëdeklarimi

Klientët familjarë të cilët do të kualifikohen për përfitimin nga kjo skemë mbështetëse do të duhet të përzgjedhin një nga subjektet e njoftuara nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë për marrjen e shërbimit.

Të gjithë klientët familjarë që plotësojnë kriteret, do të aplikojnë në portalin www.eficenca.al duke ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Portali bën renditjen e aplikimeve të para që pajisen me numrin rendor përkatës në mënyrë automatike. Brenda 2 ditëve punë nga data e pajisjes me numrin përkatës, Agjencia miraton ose refuzon aplikimin dhe njofton aplikuesin në mënyrë elektronike. Me marrjen e konfirmimit nga Agjencia, klienti familjar duhet të konfirmojë porosinë tek subjekti tregtues brenda 7 ditëve pune duke kryer pagesën në masën 30% të faturës. Mandati i pagesës së bërë dërgohet pranë Agjencisë për Efiçencën e Energjisë nga subjekti tregtar dhe regjistrohet. Klientët familjarë që nuk konfirmojnë porosinë dhe si rezultat, nuk dërgojnë mandatin e pagesës prej 30% të faturës brenda afateve të pikës 3 (brenda 7 ditëve pune nga konfirmimi i aprovimit të aplikimit) humbasin të drejtën e financimit. Këto klientë kanë të drejtë të aplikojnë përsëri. Në rastin kur klienti familjar tërhiqet nga aplikimi, pozicioni i tyre plotësohet nga aplikuesi i rradhës, deri në riplotësimin e kuotave. Nga momenti i parapagimit të faturës nga klienti familjar, subjektet tregtare duhet të instalojnë sistemin brenda 15 ditëve pune. Masat administrative për mosrespektimin e afateve parashikohen në kontratën standarte mes Agjencisë për Efiçencën e Energjisë dhe subjekteve tregtuese. Klientët familjarë në çdo rast duhet të zbatojnë legjislacionin në fuqi për instalimin e këtyre paneleve, si dhe për marrjen e dakordësisë nga bashkëpronarët e tjerë nëse është e aplikueshme.

Adresa e websiteit ose tel për më shumë info
www.eficenca.al
Email: info@eficenca.gov.al

Bizneset që ofrojnë produkte me efijencë energjitike me 0% interes

Qëllimi i kesaj skemë financimi është nxitja dhe ndergjegjësimi për investim në pajisje elektroshtëpiake që janë efijente në konsumim.

Kriza ka sjellë rritje të çmimit të energjisë elektrike kudo nëpër botë dhe kjo situatë ka prekur edhe vendin tonë. Prandaj ajo që duhet të ndodhë nga ana jonë është të mësojmë të konsumojmë energjinë në mënyrë të mençur. Por si mund ta bëjmë këtë? Këshilla e pare dhe më e rëndësishme është investimi në pajisje elektroshtëpiake që janë efijente në konsumim dhe që zakonisht vlerësohen me E deri në A+++ në shkallën e konsumimit të energjisë elektrike. Kohët e fundit nëpër dyqane pajisjesh elektronike, mund të keni vënë re se produktet që tregtohen janë të pajisura me etiketa të cilat pasqyrojnë një nivel të ndryshëm për efijencën energjitike. Ky ndryshim ka hyrë në fuqi që prej muajit Mars 2021 nga vendet e BE së, dhe ofron një mënyrë më të thjeshtë për të kuptuar se ai i vjetri. Kështu është kaluar nga një sistem që fillonte me A+++ në F, në një tjetër që thjesht shkon nga A në E.

Etiketat e energjisë ndihmojnë konsumatorët që të bëjnë një zgjedhje pasi të kenë marrë të gjithë informacionin e nevojshëm. Dhe kjo duhet të jetë njësoj në Shqipëri ashtu si në çdo vend të BE.

Një pajisje që ka një klasifikim të ulët në etiketë tregon që nuk është shumë efijente nga pikëpamja energjitike. Kështu nëse ju blini një pajisje me klas energjie G, ju do të shpenzoni më shumë energji elektrike sesa nëse blini një pajisje me klas energjie A. Nëse mendojmë për impaktin në mjedis një pajisje më efijente është gjithashtu një zgjedhje më e mirë. Poshtë shkallës së klasifikimit ju mund të shikoni një numër me disa matje në krah. Kjo sepse mënyra se si klasifikohet efijenca energjitike nga kategoria në kategori ndryshon që do të thotë matjet për një TV do të jenë të ndryshme nga ato të një lavastovilje. Shumica e klasifikimeve bëhet duke u bazuar në numrin 100 të cikleve të punës, psh sa energji harxhon një makinë larëse kur kryen më shumë se 100 larje.

Jo të gjitha pajisjet teknologjike kanë etiketa për eficientë energjitiqe.


Etiketat kanë ndryshuar vetëm në pajisjet e mëposhtme:

1. Frigoriferë
2. Makina Larëse
3. Larëse tharëse
4. Frigoriferë vere
5. Lavastovilje
6. Televizorë
7. Monitorët e kompjuterave
8. Monitorët për video lojra etj.

Partnerë të ndryshëm financiarë që operojnë në treg ju mundësojnë financim për blerje në këto dyqane elektroshtëpiake duke përzgjedhur produktet me eficientë energjitiqe. P.sh Banka Raiffeisen ju mundëson financimin për blerjet tuaja në NEPTUN sipas kushteve të mëposhtme. Procesi përfundon brenda në dyqan, pa qenë e nevojshme të shkoni pranë sporteve të bankës. Ju mund të blini produktet që dëshironi vetëm me një dokument identifikimi, në një kohë rekord. Ju mund të blini me 0% interes produktet te caktuara dhe ti paguani me keste minimale mujore deri në 48 muaj. Gjithashtu, gjatë gjithë kohës ju mund të blini produkte me financim me 0% interes deri në 18 muaj, dhe nëse jeni duke mobiluar shtëpinë dhe do të blini tre apo më shumë elektroshtëpiake të mëdha ju mund të kërkonte financim me 0% interes deri në 48 muaj.

Cilat janë dokumentat e nevojshëm?

1. Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë)
2. Nr. telefoni
3. Një numër llogarie pranë bankës që ka marrëveshje me dyqanin ku aplikoni
4. Dokumenta të tjerë sipas rastit, vetëm nëse është e nevojshme.



Gjetje dhe rekomandime

Bazuar në analizën e situatës aktuale, më poshtë janë paraqitur disa gjetje dhe rekomandime konkrete për orientimin e politikave në Shqipëri dhe mbështetjen e familjeve që janë në kushtet e varfërisë energjitike bazuar edhe në shëmbuj të vendeve të BE.

Trajtimi i varfërisë energjitike përmes politikave të integruara. Gratë janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga varfëria energjitike pasi ato mbeten jashtë vendimarrjes dhe nuk ka politika mbështetëse për to.

- Politikat energjitike dhe vendimarrja vazhdojnë të jenë të dominuara nga burrat prandaj duhet të ketë më shumë përfshirje të grave në rolet vendimarrëse në sektorin e energjisë.

Familjet e varfëra janë të predispozuar të bien në kushtet e varfërisë energjitike dhe nuk kanë mundësi të investojnë në masa për efikasitetin e energjisë apo energji të rinovueshme dhe në këto rrethana duhet të kënë prioritet në skemat financiare mbështetëse nga qeveria Shqiptare.

- Ndalimi i ligjor i ndërprerjes së energjisë për familjet të cilat nuk kanë mundësi ta paguajnë atë (koordinim me shërbimin social).

- Mbështetje financiare për qytetarët vulnerabël (masa dhe programe afatshkurtër e afatgjatë).

Skemat e mbështetjes financiare për energjitë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë në vendin tonë janë në nivele shumë të ulta, kjo krahasuar me programet mbështetëse të vendeve të Bashkimit Evropian apo dhe vendet e rajonit.

- Është shumë e rëndësishme që Shqipëria të mbështesë familjet në kushtet e varfërisë energjitike nëpërmjet investimeve në energji të rinovueshme duke përdorur skema të cilat kanë rezultuar të sukseshme në vendet e rajonit apo edhe me gjërë.

- Agjensia e Efikasitetit të Energjisë duhet të hartojë dhe zbatojë një plan veprimi për rinovimin e stokut të ndërtesave nën parimin e rritjes së performancës së tyre energjitike.

- Lehtësimi i kuadrit ligjor dhe procedurave administrative përsa i përket familjeve të cilat duan të investojnë në energji të rinovueshme për vetëkonsum.

- Komunitetet e energjisë duhet të ofrojnë mbështetje direkte me pajisje me efikasitet energjie për familjet në nevojë.

- Sektori bankar duhet të lehtësojë procedurat e marrjes së një kredie për termoizolim dhe hidroizolim dhe shtëpive, mundësisht me norma interesi '0' ose sa më të ulta.

Bashkitë duhet të hartojnë plane lokale të veprimit për reduktimin e riskut nga ndryshimet klimatike dhe të planifikojnë programe financimi (pjesë dhe buxhetimi të përgjigjshëm gjinor) dhe rinovimi për banesat e vjetra të cilat nuk plotësojnë kushtet për të qëne godina me efikasitet energjitike.

Bibliografia

Studimi: Gjetjet paraprake dhe studimi mbi konsumin e energjisë elektrike në shqipëri dhe sjellja konsumatore. Autori: Enti Rregullator i Energjisë - Viti: 2023

Raporti Vjetor: Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2022. Autori: Enti Rregullator i Energjisë - Viti: 2023

Vendimi i Bordit: Shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e kodit të transmetimit. Autori: Enti Rregullator i Energjisë - Nr. 63, Datë 11.04.2022

Raporti Vjetor: Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2020. Autori: Enti Rregullator i Energjisë - Viti: 2021

Studimi: Konsumi i energjise elektrike në familje. Autori: Enti Rregullator i Energjisë - Viti: 2009

Studim: Bilanci-Kombëtar-i-Energjisë-2022. Autori: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - Viti 2022

Artikull website: Si të aplikojmë për "Fondin e Komuniteteve". Autori: Bashkia Tiranë

Udhëzues: Hap pas hapi se si të aplikoni për financimin e teknologjisë. Autori: GEFf www.ebrdgeff.com

Artikull: Produktet që kursejnë energji. Autori: Neptun.al